



---

**VENDIM**  
**Nr.15 Datë 15.02.2010**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË**  
**SHOQËRISË “400 KV” SH.P.K NË AKTIVITETIN E**  
**TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1, dhe 3 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, gërma “a”, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.02.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “400 kv” sh.p.k si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për liçensim në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike,

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “400 kv” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa a, b dhe c) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërma a,b,c,d,f dhe g) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni finaciuar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa a, b dhe d) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Bordi i Komisionereve



---

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licensë të shoqërisë “400 kv” sh.p.k në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



---

Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**VENDIMIN**  
*Nr.15 Datë 15.02.2010*

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË**  
**SHOQËRISË “400 KV” SH.P.K NË AKTIVITETIN E**  
**TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____

